Nr. 7469/1 Prot
06.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 787/1 prot. Shkodër më 05.11.2026

LËNDA: Mbi vendimin nr. 76, datë 29.10.2026 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshua, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut",të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 20, neni 23 pika 4, neni 54, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "c", ligji nr. 9270 datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave", i ndryshuar, neni 4/1 (shtuar me ligjin nr.9951 datë 10.07.2008) ligji nr.94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendore të nderit në RSH, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau dejës nr. 7466 prot., datë 02.11.2026 "Dërgoj vendimet e këshillit bashkiak Vau Dejës të datës 29.10.2026" *u njoh me vendimin nr. 76 datë 29.10.2026 " Për ndryshim emërtimi e një segmenti të një rrugë në Vau Dejës nga Rruga Demokracia në rruga Imzot Simon Kulli "*

Ky vendim i këshilli bashkiak, nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative, për të cilat Prefekti në zbatim të nënit 8, shkronja "a" e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar ka detyrim të shprehet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Holta DUDA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr 76 Datë 29/10/2026

"Për ndryshim emërtimi e një segmenti të një rruge në Vau Dejës"

Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore "neni 20. neni 23, pika 4,neni 54, ligji nr.9270, datë 29.07.2004 Për sistemin Emërtimi e adresave i ndryshuar, Neni 4/1 (shtuar me ligjin nr.9951, datë 10.07.2008) ,Shkresen e Ministrisë së Brendshme Nr.419 Prot date 11.02.2020, Shkresen e Ministrisë së Brendshme nr. 3067,datë 07.12.2020.si dhe nisur nga Urdheri i Kryetarit te bashkise Nr. 838, datë 21.10.2026" Për Ndryshimin e Emertimit te Segmentit Rrugor Nr. 03360001, Nga Demokracia ne "Imzot Simon Kulli",Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1.Miratimin e këtij Projekt Propozimi dhe ndryshimin e emertimit të Segmentit Rrugor Nr. 03360001, Nga „Demokracia" ne "Imzot Simon Kulli", sipas hartes bashkelidhur.

Nr.Rruge	Emërtimi rrugës është	Bëhet
03360001	DEMOKRACIA	IMZOT SIMON KULLI

2.Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit te Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike per zbatimin e vendimit, si dhe nepunesi i menagjimit te sistemit te adresave per reflektimin e ndryshimeve perkatese.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 te ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", te ndryshuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

Kryetar Këshilli
Ervis Shimaj

Sektretar Këshilli
Ardian Çelepija

Miratuar me 17 vota
Vota pro 17
Vota kunder -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 02.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT,KADASTRËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Projekt – Propozim
Nr. 1 Date : 22/10/2026

Për ndryshimin emërtimin e një segmenti te një rruge në Vau Dejës.

Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"neni 20,neni (Neni 20: **E drejta e iniciativës qytetare** *,1.Çdo komunitet,nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij,ose jo më pak se një përqind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për cështje që janë Brenda juridiksionit tqë njesisë së vetëqeverisjes vendore),* ***neni 23***,(Neni 23: Funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, pika 4. *Ndërtimin ,rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimin rrugor,të trotuarëve dhe shesheve publike vendore.)* ***neni 54*** *(Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, germa11),* ***vendos për emërtimin e rrugëve,shesheve territoreve,intitucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë****), ligji nr.9270,datë 29.07.2004 'Për sistemin e adresave' ndryshuar,* ***Neni 3. Emërtimi I bulevardeve,rrugëve,rrugicave ,shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore,nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen****. Neni 4/1 (shtuar me ligjin nr.9951,datë.10.07.2008)* ***1. Cdo njësi e qeverisjes vendore krijon,përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave****. Shkresen e Ministrisë së Brendshme Nr.419 Prot date 11.02.2020, Shkresen e Ministrisë së Brendshme nr.3067 ,datë 07.12.2020,si dhe nisur nga Urdheri I Kryetarit te bashkise Nr. 838, datë 21.10.2026 " Për Ndryshimin e Emertimit te Segmentit Rrugor Nr. 03360001, Nga Demokracia ne "Imzot Simon Kulli".*

PROPOZOJME

Miratimin e këtij Projekt – Propozimi dhe ndryshimin e emertimit *Ndryshimin e Emertimit te Segmentit Rrugor Nr. 03360001, Nga Demokracia ne "Imzot Simon Kulli"*, sipas hartes bashkelidhur.
Të ndryshohet emërtimi i segmentit te rrugës:

Nr. Rruge	Emri I rruges eshte:	Propozohet:
03360001	DEMOKRACIA	*"IMZOT SIMON KULLI*

Bashkëlidhur relacion mbi kontributin e Imzot Simon Kulli , dhe harta përkatese.

Adresa: "Rruga Qafa e Gurit" Vau Dejes, Telefon/Faks 00355 2612 0006 , e-mail: info@vaudejes.gov.al

KRYETAR

KRISTIAN SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARE

ALEKSANDRA GJONI



Juriste : Dorina Lekaj

Ark. Xhoel Nikaj

Drejtor: Edmir Abdija

Adresa: "Rruga Qafa e Gurit" Vau Dejes, Telefon/Faks 00355 2612 0006 , e-mail: info@vaudejes.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

Nr.7193 Prot **Vau Dejës, me 21.10.2026**

URDHËR

Nr. 838, datë 21.10.2026
"PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR NR. 03360001 NGA "DEMOKRACIA" NË EMËRTIMIN "DOM SIMON KULLI ".

Bazuar në nenin 113, pika 2 të ligjit Nr.8417, datë 21.10.1998, "*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/a dhe b, neni 54 pika, ll , në Ligjin nr. 112/2013 datë 04.04.2013 "*Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë*" neni 17 dhe në vijim, në Ligjin nr.94/2022 datë 22.12.2022 "*Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë*", Ligji Nr.9270, datë 29.07.2004 "*Për sistemin e Adresave*";

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e Emërtimit të Segmentit Rrugor Nr.03360001 nga Demokracia të marrë emërtimin Rruga e "***Dom Simon Kulli***", më motivacionin "*Kontributin e vazhdueshëm që ka dhënë në Dioqezën e Sapës për qytetin ku ai jetoj dhe mbarë zonat rurale ku ai shërbej*".
2. Ngarkohet për zbatimin e urdhrit Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Investimeve Publike.
3. **Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

KRYETARI

Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/ KRYETAR

Aleksandra Gjoni

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS -

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al

Rruga Demokracia

https://geoportal.asig.gov.al
Data e Printimit: 20.10.2026.




240915 470383.740 4652684.915

240215 470383.740 4652313.215

https://geoportal.asig.gov.al:ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e ...tit publik që i ka krijuar ato.

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH


Emri DEMOKRACIA
03360001
Gjatesia 66.11 m

RELACION PËR IMZOT SIMON KULLIN

IPESHKËV I DIOQEZËS SË SAPËS

Imzot Simon Kulli ka lindur me 14.02.1973 në fshatin Pistull të rrethit të Shkodrës, që shtrihet brenda territorit të Dioqezës së Sapës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje.

Me 2 shkurt 1992 është pranuar në Seminarin Ndërdioqezan Shqiptar "Zoja e Këshillit të Mirë" në Shkodër, ku kreu dy vite parapërgatitje për fillimin e studimeve filozofike e Teologjike.

Në vitin 1994 fillon studimet e Filozofisë. Me të mbaruar studimet e Filozofisë, në vitin 1996 fillon studimet e Teologjisë. Duke e njohur dhe përqafuar gjithnjë e më tepër thirrjen, dom Simoni shugurohet diakon me 14 shtator të vitit 1999, në Katedralen e Shkodrës nga Arqipeshkvi i Shkodër Imzot Angelo Massafra. Përvoja e tij baritore në periudhën e Diakonatit qe e ndarë në dy realitete: gjashtë muaj shërbeu në famullinë e "Shën Shtjefnit" në Shkodër, me famullitar Mons. Lucjan Avgustinin, dhe katër muaj të tjerë shërbeu në famullinë "Zoja Rruzare" në Dajç të Zadrimës (Lezhë), nën kujdesin e famullitarit dom Injac Dema.

Në vitin Jubilar 2000, me 29 qershor, shugurohet meshtar në Katedralen e Shkodrës së bashku edhe me katër meshtarë të tjerë shqiptarë. Këta qenë shugurimet e para meshtarake pas periudhës së egër të regjimit komunist në Shqipëri.

Pas shugurimit meshtarak, emërohet **Sekretar dhe Kancelar i Dioqezës së Sapës**, me ipeshkëv Imzot Dodë Gjergjin, dhe njëkohësisht ndihmës famullitar në Dajç të Zadrimës (2000-2004), pranë përkujdesjes baritore të famullitarit dom Injac Dema duke shërbyer tek besimtarët e kësaj zone si në fushën baritore, ashtu edhe sociale dhe shoqërore.

Nga viti 2004 e deri në vitin 2007, emërohet **Famullitar i Katedrales e "Lumja Tereza e Kalkutës" sot "Shën Tereza e Kalkutës", në famullinë e "Shën Kollit" në Vau-Dejës.** Në të njëjtën periudhë mbuloi edhe detyrat si Ekonom i Dioqezës dhe Drejtor i Caritas-it Dioqezan SAPA, ku këtë të fundit e mbajti deri në vitin 2012.

Në vitin 2007, me ardhjen e Ipeshkvit të ri, Imzot Lucjan Avgustinit, me dekret të tij, riemërohet po me të njëjtat detyra të mëparshme në Dioqezë siç i theksuam më lart. Gjatë kësaj periudhe si famullitar, gjithë shërbimin e tij ia kushtoj banorëve të këtij vendi, duke u kujdesur në baritoren shpirtërore, sociale etj. duke u ardhur në ndihmë njerëzve të sëmurë, njerëzve të varfër, si dhe duke ndërtuar edhe shtëpi për shumë familje që ishin në mjerim. Përveç detyrës si famullitar në vitin 2012 u emërua edhe përgjegjës i Shtëpisë së Bamirësisë, detyrë të cilën e mbajti deri në ditët e fundit të jetës së tij.

Me kalimin në amshim të Bariut të Dioqezës Imzot Lucjan Avgustini, (22. 05. 2016) dom Simon Kulli me dt. 02.06.2016 emërohet nga Këshilli i Konsultorëve të Dioqezës, **Administrator Dioqezan i Sapës**. Me datën 15 qershor 2017, Ati i Shenjtë Papa Françesku e emëroi për Ipeshkëv të Dioqezës Sapës. Ndërsa Shugurohet Ipeshkëv me 14 shtator 2017 në Katedralen Shën Tereza e Kalkutës në Vau-Dejës. Që në rithemelimin e Dioqezës së Sapës në vitin 2000 Dom Simon Kulli ishte krahu i djathtë i ipeshkvinjëve paraardhës dhe themelues i ringritjes së Strukturave Dioqezane.

Që me Emërimin dhe Shugurimin e Tij Ipeshkvor, Mons. Simoni e udhëhoqi grigjën e tij si bari i Sapës, duke dhënë kontributin e tij të gjithëanshëm në mënyrë të pakursyeshme dhe bujare si nga ana shpirtërore ashtu edhe baritore, shëndetësore dhe shoqërore.

"Caritas christi urget nos - Dashuria e Krishtit na nxit. (2 Cor 5,14)" Ishte kjo motoja që Mons. Simoni kishte zgjedhur për shërbimin e tij baritor, të cilën me shumë dashuri e gdhendi në stemën e tij ipeshkvore të ndërthurur nga ngjyrat e kuqe dhe të zezë -simbol i gjakut të martirëve dhe i kombit Shqiptarë.

Nga dt. 20 shkurt 2024 u zgjodh zv/president i Konferencës Ipeshkvore Shqiptare e njëkohësisht mbulonte edhe detyrën e Presidentit të Misioneve dhe Emigracionit, pranë kësaj konference.

Kontributi i tij ishte i jashtëzokonshëm në fushën e bamirësisë, shëndetësisë, sociales dhe shoqërores. Ishte promovues i paqes dhe i faljes. Gjithë jetën e tij tregoi një kujdes të jashtëzakonshëm ndaj personave me Aftësi Ndryshe, dhe ndaj personave të shtresës më të varfër. Motoja e tij ishte për t'i shërbyer të varfërve ndër më të varfërit. Butësia dhe përvujtëria e tij ishin model për gjithkënd që e takonte Ai i trajtonte njerëzit në nevojë vetëm nëpërmjet dashurisë dhe mirësisë, dhe bëntë të pamundurën për t'ju ardhur në ndihmë. Shërbimi i tij 20 vjeçar në Vau Dejës, ka lënë gjurmë të mëdha në zemrat e njerëzve. Pa dallim feje është munduar ti japë zgjidhjen e problemeve kujtdo që ka trokitur në derën e tij. Aftësia dhe mbështetja që tregonte edhe me autoritetet civile bënte të krijonte ura bashkëpunimi ndërinstitucionale për të mirën e përbashkët dhe për vendin. Gjithmonë dëshira e tij ishte për të shërbyer dhe punuar në të mirën e njerëzimit. Ai dinte të ndimonte dhe qëndronte pranë me besnikëri dhe përkushtim. Zelli i tij për punën dhe ndjeshmëria që tregonte ndaj banorëve ishte karakteristikë e tij që e shoqëruan gjatë gjithë jetës. Ai ishte i kundogjendur në çdo shërbim dhe nevojë ku e thërriste detyra e tij si bari shpirtëror. Ishte përkrahës i çdo lloj moshe, qoftë me fëmijët, me të rinjtë, me të moshuarit, me bashkëpunëtorët etj. Imzot Simoni gjente kohë për gjithçka. Ngrihej edhe nga buka kur njerëzit kishin nevojë për ta takuar ose për t'i kryes një shërbim. Në çdo punë apo shërbim ishte i kujdesshëm dhe i vëmendshëm për mbarëvajtjen e saj.

Si famullitar Imzot Simoni ka shërbyer tek çdo besimtar, qoftë me shërbimin e tij baritor, qoftë me vizitat në familje, qoftë me themelimin e grupeve të Legjionit të Marisë, grupit të të Rinjëve, Këshillin Baritor etj. Një tjetër vepër është edhe misioni me fëmijët e Kopshtit parashkollor "Gianluca Felici" në Vau Dejës, ku për shumë vite me radhë si famullitar, Imzot Simoni i ka ndjekur, mbështetur dhe është përkujdesur për këto breza që kanë patur fillimet e para në këtë vend në rrugën e dijes.

Si Ipeshkëv i Dioqezës Sapë dhe president i Caritasit Dioqezan, bëri një punë kolosale në mbështetje të nevojtarëve. Bëri të mundur realizimin e shumë projekteve në fusha të ndryshme që i përkitnin baritores sociale, duke krijuar mundësi të reja për jetën e banorëve si p.sh.

- Zhvillimin e ekonomisë familjare, duke krijuar mundësi vetëpunësimi për familjet në nevojë;
- Ndërtimin e shtëpiave duke ju krijuar kushte më të mira jetese;
- Ndihmën me paketën ushqimore të shportës për familjet e varfëra;
- Emergjencat civile

- Themelimin e vullnetarizmit me të rinjtë e famullisë Vau Dejës, ku përmes shërbimit të tyre vullnetar ju vinin në ndihmë Personave me Aftësi ndryshe dhe njerëzve të varfër;

- Themelimin e Qendrës Ditore po me Personat me Aftësi Ndryshe

- Aktivitete me fëmijët dhe të rinjtë;

- Kampet verore

- Kampionatin e Futbollit për djemtë dhe Kampionatin e Volejbollit për vajzat

- Kampionatin e Shahut;

- Maratona e biçikletave;

- Darkën e Bamirësisë;

Të tjera vepra të Imzot Simon Kullit ishte edhe ndërtimi i Kishës "Dom Luigj Prendushi" në Naraç, dhe Kisha e "Shën Gjon Pagëzuesit" në Pukë. Janë dy vepra madhështore që Imzot Simoni i ndërtoi gjatë periudhës që udhëhoqi Dioqezën e Sapës si Ipeshkëv. E gjithë grigja e tij që i ishte besuar, tregonte më së miri dashurinë e bariut që ai kishte për to, në çdo cep të që shtrihet kjo dioqezë, duke filluar që nga Troshani e mbarë Zadrima, në Pukë, Fushë Arrës, Tropojë dhe Kukës. Vepra e Imzot Simonit ka lënë gjurmë të thella në Dioqezën e Sapës, dashuria dhe kujdesi i tij do mbeten të paharruar nga të gjithë. Ai edhe në ditën e fundit të jetës së tij, me 28 nëntor ka shoqëruar grupin e të rinjëve në takimin Kombëtar të Rinisë që u zhvillua në Rrëshen. Ndërsa me datën 29 nëntor 2025, ndërsa po bëhej gati për të shkuar bashkë me Korin Dioqezan në Takimin Kombëtar në Tiranë, Zoti e thirri pranë vetes në orën 8 të mëngjesit.

Vau Dejës, 23. 10. 2026

Përgatiti

Violeta Marashi

Dorina Lekaj

Sqarim për ndryshimin e emërtimit

të rrugës së pedonales së qytetit Vau Dejës

I nderuar Kryetar i Bashkisë, z. Kristjan Shkreli

Së pari, Ipeshkvia e Sapës, ju falenderon për propozimet nga ana e institucionit tuaj që të nderoni figurën e ish – Ipeshkvit të Sapës, Imzot Simon Kullit, pas vdekjes së tij.

1. Rruga për të cilën propozoni që të emërtohet në emrin e tij, të marrë emërtimin: **"IMZOT SIMON KULLI"**

2. Motivacioni për titullin "Qytetar Nderi"

   "Qytetar Nderi" i Bashkisë Vau Dejës në nderim të figurës së Imzot Simon Kullit, (pas vdekjes), Ipeshkëv i Dioqezës së Sapës, me motivacionin ***"Për kontributin e tij të jazhtëzakonshëm dhe të çmueshëm në promovimin e kujdesit dhe të integrimit shoqëror të Personave me Aftësi Ndryshe, si edhe për solidaritetin e tij dhe veprimtaritë bamirëse ndaj shtresave më të varfëra të Bashkisë Vau Dejës".".***

Me respekt

Atë Mariano Tarantino

Administrator Dioqezan i Sapës

New message

Inbox 642
Unread
Starred

Sent
Drafts 49
Scheduled

Trash
Spam
Archive

Folders
New Folder

More

← Back

Sqarim

Inbox

Dioqeza Sapes
To: me, and 1 other · Thu, Oct 22 at 2:48 PM

Nga Ipeshkvia e Sapes
Vau Dejes

1 attachment

Download

Saktesim.docx
DOCX · 13.4 KB

Reply Reply all Forward

Starred Contacts Mor

Your Trading Edge

ade the
lomentu

Leverage up to 1:5
No Commissior

Trade Now

